



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:060791

Datë: 07.06.2024

Numri i dokumentit: 05792884

C.nr.1525/2020

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Berat Spahiu, me bashkëpunëtorin profesional Emine Hoti, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Lindita Maliqi nga Kompania „VAR SOLUTION” sh.p.k me seli në Fushë Kosovë, kundër të paditurit A.Q nga fsh....- Komuna e Bujanocit, me objekt kontesti rimbursimi i dëmit, me vlerë të kontestit prej 10,499.00 euro, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor e publik me datë 24.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet si e bazuar me ligj kërkesëpadia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë dhe detyrohet i padituri A.Q nga fsh....- Komuna e Bujanocit, që paditëses t’ia rimbursojë shumën 10,499.00€, në emër të dëmit material dhe jo material të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 22.07.2010 në Gjilan, dhe atë me kamatë sipas mjeteve të deponuara në bankat afariste mbi një vit pa destinim të caktuar, duke llogaritur nga data 15.08.2019 e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së Aktgjykimit nën nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm ligjor.

II. Detyrohet i padituri, që paditëses t’ia kompenzoj shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 100.00€, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së Aktgjykimit, nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm ligjor.

A r s y e t i m

Paditësja Byroja Kosovare e Sigurimit me seli në Prishtinë, më datë 02.06.2020, ka dorëzuar në këtë gjykatë padi kundër të paditurit A.Q nga fsh....- Komuna e Bujanocit dhe ka kërkuar që të detyrohet i padituri, që paditëses t’ia rimbursojë shumën 10,499.00€, në emër të dëmit material dhe jo material të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 22.07.2010 në Gjilan, dhe atë me kamatë sipas mjeteve të deponuara në bankat afariste mbi një vit pa destinim të caktuar, duke llogaritur nga data 15.08.2019 e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së Aktgjykimit nën nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm ligjor.

Paditësja në padi ka theksuar se i padituri më datë 22.07.2010, rreth orës 10:45 në Gjilan, ka shkaktuar aksident trafiku me automjetin „OPEL ASCONA” me targa të regjistrimit VR-981-44. Deri te ky aksident i trafikut ka ardhur nga pakujdesia e automjetit “A”, të cilin e drejtonte

A.Z. Nga ky aksident dëme i janë shkaktuar të dëmtuarit R.K. Ka shtuar se automjeti i cili ishte shkaktar i këtij aksidenti në momentin e shkaktimit të tij ka qenë pa mbulesë siguruese, respektivisht me afat të skaduar të policës së sigurimit. Tutje ka shtuar se në ndërkohë i dëmtuari në këtë aksident R.K ka paraqitur padi për kompenzim dëmi ndaj të paditurës BKS-së me numër të lëndës C.nr.559/11 në Gjykatën Themelore në Gjilan. Gjykata e Apelit ka marr Aktgjykim AC.nr.1533/15 më datë 04.07.2019 me të cilin është ndryshuar Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan C.nr.559/2011. Andaj konform Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Ac.nr.1533/15, BKS ka bërë kompenzimin e të dëmtuarit R.K në emër të të gjitha formave të dëmit material dhe jomaterial të shkaktuar si pasojë e aksidentit të trafikut të datës 22.07.2010, në shumë prej 10,499.00€, e cila është paguar më datë 15.08.2019. Paditësi në procedurën jashtëgjyqësore ju ka drejtuar të paditurit, por nuk kanë mundur ta mbyllin këtë çështje.

Gjykata me Aktvendimin C.nr.1525/2020 të datës 06.03.2024, të paditurit A.Z i ka caktuar përfaqësuesin e përkohshëm „Pro Bono” Jeton Lakna avokat nga Gjilani, pasi që i padituri jeton në fshatin D, Komuna e Bujanovcit dhe gjykata të njëjtin nuk ka mundur ta ftoj për seancë gjyqësore, pasi që tani për tani nuk ekziston ndonjë Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar të Kosovës dhe Serbisë, ku i padituri e ka edhe adresën.

Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit A.Z, avokati Jeton Lakna nga Gjilani, në përgjegjen në padi dhe gjatë shqyrtimeve gjyqësore e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses, pasi që paditësja me rastin e paraqitjes së padisë dhe nga të thënat në të shihet se automjeti i cili ishte shkaktar i këtij aksidenti, në momentin e shkaktimit të aksidentit ka qenë pa mbulesë siguruese, respektivisht me afat të skaduar të policës së sigurimit. Mirëpo ka shtuar se nëse i referohemi Procesit të aksidentit me nr. rendor 014944 dhe nr.të aksidentit CR.3004-304/10 të datës 22.07.2010, në pjesën e majtë të procesit respektivisht ku përshkruhen shënimet e Njësisë A, që konsiderohet shkaktar të aksidentit, ku bëhet fjalë për siguruuesin e mjetit, përpos tjerash shkruan se automjeti është i siguruar në kompaninë e sigurimit „Triglav” nga R.Serbisë, me numër të policës së sigurimit nr.04003683551, me afat të skadimit me datën 19.11.2010 dhe nëse i referohemi kësaj datë të skadencës së policës së sigurimit dhe datës së aksidentit i cili kishte ndodhur më datë 22.07.2010, atëherë vijmë në përfundim se automjeti „Opel Ascona” me tabela të regjistrimit VR981-44, si shkaktar i aksidentit të datës 22.07.2010 kishte policë të sigurimit valide edhe për 4 muaj të tjerë.

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: Raporti policor i aksidentit me nr. Cr-3004-304/10 i datës 22.07.2010, së bashku me skicën e matjeve nga vendi i ngjarjes; urdhër transferi bankar i datës 15.08.2011; Superekspertiza mbi aksidentin e komunikacionit sipas lëndës C.nr.559/11; Aneksi i superekspertizës sipas lëndës së njejtë; Aktgjykimi C.nr.559/2011 i datës 18.02.2015; Aktgjykimi AC.nr.1533/15 i datës 04.07.2019 me të cilin pjesërisht është aprovuar ankesa e të paditurës BKS dhe është ndryshuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, në pikën I dhe II të dispozitivit dhe janë gjykuar shumat përkatëse si në dispozitiv të këtij aktgjykimi; Aktgjykimi Pnr.127/2013 të datës 18.03.2014; Superekspertiza mjeksore për palën e dëmtuar.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të paditësit dhe provave të lartcekura, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadija e paditëses është e bazuar dhe si të tilë e ka aprovuar plotësisht.

Në mes palëve nuk është kontestues fakti se me datën 22.07.2010, është shkaktuar aksident i komunikacionit, me q’rast lëndime trupore ka pësuar këmbësori R.K nga Gjilani dhe se fajtor

dhe përgjegjës për dëmin e shkaktuar është ngasësi i automjetit i markës „Opel” tipi „Ascona” A.Z nga fshati ...-Komuan e Bujanovcit, ngase fakti i tillë konfirmohet edhe nga vet Raporti i aksidentit i lëshuar nga Policia e Kosovës me numër 3004-304/10 i datës 22.07.2010, Aktgjykimi C.nr.559/2011 i datës 18.02.2015, pataj Aktgjykimi AC.nr.1533/15 i datës 04.07.2019 me të cilin pjesërisht është aprovuar ankesa e të paditurës BKS dhe është ndryshuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjiilan, në pikën I dhe II të dispozitivit dhe janë gjykuar shumat përkatëse si në dispozitiv të këtij aktgjykimi si dhe Aktgjykimi Pnr.127/2013 të datës 18.03.2014

Po ashtu, nuk është kontestues fakti se i dëmtuari nga ky aksident, R.K kishte realizuar kërkesën e dëmit material dhe jomaterial, konform Aktgjykimit C.nr.559/2011 i datës 18.02.2015 dhe Aktgjykimi AC.nr.1533/15 i datës 04.07.2019, me qka Byroja Kosovare e Sigurimit me seli në Prishtinë, të dëmtuarin e ka kompenzuar në shumën e të hollave në lartësi prej 10,499.00 euro, fakt që konfirmohet nga urdhër transferi bankar në NLB Bank, i datës 15.09.2010, dhe se një kompenzim i tillë është bërë nga BKS me seli në Prishtinë, konform nenit 10 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia /Ligji nr. 04/L-018 i datës 23.06.2011/ku është përcaktuar se „Kompenzimi i dëmit material dhe jomaterial bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve” dhe se konform nenit 14.3 të Ligjit ku është përcaktuar se „Siguruesi pas përmbushjes së detyrimit nga ky nen dhe paragrafi 3. i nenit 9 të këtij ligji, ka të drejtë të kërkojë rimbursim në procedurë regresi ndaj personit përgjegjës për dëmshpërblimin e paguar, edhe pse personi nuk kishte mbulesë siguruese”, pra, tani paditësja duke u mbështetur në nenin 14.3. të Ligjit të lartcekur ka të drejtën e regresit ndaj shkaktarit të dëmit.

Kontestuese në mes palëve mbetet fakti nëse i padituri A.Z, ka pasur të afatshme policën e sigurimit dhe nëse ajo policë e sigurimit vlenë edhe për teritorin e Republikës së Kosovës, ku edhe është shkaktuar dëmi.

Gjykata, duke u bazuar në përmbajtjen e shënimeve nga Raporti policor i aksidentit me nr. Cr-3004-304/10 i datës 22.07.2010, vërteton se shkaktari i aksidentit A.Z, ka pasur të siguruar automjetin e tij në kompaninë e sigurimit „Triglav” R.Serbisë, me numër të policës së sigurimit nr.04003683551, me afat të skadimit me datën 19.11.2010 dhe nëse i referohemi kësaj datë të skadencës së policës së sigurimit dhe datës së aksidentit i cili kishte ndodhur më datë 22.07.2010, atëherë vijnë në përfundim se automjeti „Opel” tipi „Ascona” me tabela të regjistrimit VR981-44, kishte policë të sigurimit valide edhe për 4 muaj të tjerë, por që me rastin e hyrjes në teritorin e Republikës së Kosovës, nuk ka pasur policën kufitare /TPL/ për të pasur sigurim për dëmet eventuale të shkaktuara jashtë territorit të Republikës së Serbisë, përkatësisht në territorin e Republikës së Kosovës, ngase vetëm përmes policës kufitare- TPL, përjashtohet përgjegjësia e tij për dëmin e shkaktuar, kurse në mes dy shteteve deri me datën 19 prill 2013, nuk ka pasur memorandum mirëkuptimi për kompenzimin e dëmeve e që këtë fakt e konfirmon vet Memorandumi i Mirëkuptimit i lidhur në frymën e Marveshjes së Brukselit të datës 19. prill 2013, në mes Shoqatës së Sigurimiti Serbë /SHSS/ dhe Byrosë Kosovare të Sigurimit /BKS/ dhe në këto rrethana konsiderohet se i padituri në kohën e shkaktimit të aksidentit, nuk ka pasur policë të sigurimit kufitar TPL dhe në bazë të kësaj është i detyruar që paditëses t’ia rimbursojë dëmin e shkaktuar.

Gjykata rikujton palët se Rregullorja e UNMIK-ut 2001/25 e datës 5 tetor 2001, e cila ka qenë në fuqi në kohën e aksidentit dhe e cila me datë 23.06.2011 shfuqizohet me hyrjen në fuqi

të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia /Ligji nr. 04/L-018/ ka përcaktuar përmbajtjen dhe natyrën e policës së sigurimit kufitar TPL, duke potencuar se „*TPL Polisa e sigurimit kufitar---Drejtuesi i mjetit motorik me regjistrim të huaj i cili nuk ka një dokument ndërkombëtar të vlefshëm të sigurimit të autopërgjegjësise, është i detyruar të lidhë kontratë të sigurimit kufitar të autopërgjegjësise të vlefshme në territorin e Republikës së Kosovës, me periudhë vlefshmërie jo më pak se pesëmbëdhjetë (15) ditë. Byroja është kompetente për organizimin dhe zbatimin e sistemit të sigurimit kufitar të autopërgjegjësise. Kur drejtuesi i mjetit motorik nuk kontraktonte sigurimin kufitar, nuk i lejohet hyrja me këtë mjet motorik në territorin e Republikës së Kosovës pa e përmbushur këtë detyrim. I dëmtuari, të cilit i është shkaktuar dëm nga përdorimi i një mjeti motorik me regjistrim të huaj i pajisur me sigurim kufitar, ka të drejtën të parashtojë kërkesë dëmshpërblimi tek Byroja Kosovare e Sigurimit*” andaj, në këtë gjendje faktike të vërtetuar se i padituri pos policës së sigurimit të lëshuar nga Kompania e Sigurimit „Triglav” në Republikën e Serbisë, nuk ka pasur policë të sigurimit kufitar, e duke u bazuar edhe në Ligjin për Mardhëniet e Detyrimeve të ish RSFJ i cili ka hyrë në fuqi me datë 1 tetor 1978 dhe është i zbatueshëm në kohën e krijimit të raporti juridiko civil, gjykata ka aprovuar kërkespadinë e paditëses si të bazuar në ligj, ngase në nenin 154 të ish LMD-së është përcaktuar se „*Kush i shkaktonte tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij*” lidhur me nenin 158 ku është përcaktuar se „*Fajsia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia*” lidhur me nenin 178 të ish LMD-së, ku është përcaktuar se „*Në rast aksidenti të shkaktuar nga automjeti në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një poseduesiseduesi të automjetit vihen në zbatim rregullat mbi përgjegjësinë në bazë të fajësisë*“ dhe nenin 185 ku është përcaktuar se „*Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e ekzistuar para se të shkactohej dëmi. Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë kompensim në të holla.*” Kamata dhe llogaritja e saj është vendosur nga ana e gjykatës, konform Mendimit Juridik nr. 265/2020 të datës 02.12.2020 të Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me kamatën për mjetet e deponuara mbi një vit pa destimin i veçantë, ngase vet paditësja e kërkoi në këtë lartësi të vendosur.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke u bazuar në nenin 452.1 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e paditëses në këtë kontest dhe e ka detyruar të paditurin, që paditëses t’ia kompenzojë shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 100.00€, në emër të taksës gjyqësore për padi, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së Aktgjykimit, nën pasojat e përmbartimit të dhunshëm ligjor.

Nga të cekurat më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2020:060791, 05.06.2024

Gjyqtari,
Berat Spahiu

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditë, pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.